



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	24.03.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHK 2985/2023			114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.336/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Ardita Haxhnikaj dhe Arben Mehmeti- anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional- ne cilësin e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.336/2023 të datës 08.2.2023, të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit, Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "kompensimi material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.03.2023, mori këtë;

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 336/2023 e datës 08.02.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi me Nr. 01-181/01-990, i datës 04.01.2023 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit.

**Arsyetim**

Menaxheri i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, më datën 04.01.2023 ka nxjerr vendimin me numër Nr.01-181/01-990 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës për nëpunësen civile për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njoh kompensimin për shkak të pensionimit në lartësinë e një (1) page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesja me date 06.02.2023 ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 01-120 Nr.18473 te Zyra e Personelit në Komunën e Prizrenit me anë të cilës ka kërkuar që ti kompensohen tri (3) paga pasi që e njëjta do të pensionohet. Ndërsa Menaxheri i Personelit në, Komunën e Prizrenit përmes përgjigjes (pa numër dhe datë) ka refuzuar kërkesën e ankueses me arsyetim që nuk ka bazë ligjore pasi që baza mbi të cilën kërkohen këto

befinicione ka qenë Marrëveshja e Përgjithshmen Kolektive , e cila ka qenë në fuqi nga data 01.01.2015 deri me datën 31.12.2017 ndërsa e njëjta marrëveshje është shfuqizuar.

Ankuesja e pa kënduar me vendimin me numër Nr.01-181/01-990 të datës 04.01.2023 të organit të punësimit me datën 08.02.2023 ka parashkruar ankesë me numër të protokollit 1575/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim që vendimi me numër Nr.01-181/01-990 i datës 04.01.2023 i organit të punësimit lidhur me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit, përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikim i gabuar i dispozitave ligjore. Ndërsa me datën 17.03.2023 përmes parashtrësës me numër të protokollit 2788/2023 ankuesja e ka plotësuar ankesën duke i bazuar pretendimet në Ligjin Nr.03/L-147 Rregullores Nr.33/2012 si dhe Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 13.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prizrenit ndërsa me datën 02.03.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prizrenit.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike;** Ankesën me numër të protokollit 1575/2023 të datës 08.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01-181/01-990 të datës 04.01.2023 të Menaxherit të Personelit në Komunën e Prizrenit; Librezen e punës (pa datë dhe numër); Vendimin e datës 10.01.2023 të Udheheqësit të Zyrës së Pensioneve në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve; Shkresën me numër 4/2-413-2454 të datës 16.06.1993; Vendimin me numër 4/1-556 të datës 30.12.1991; Parashtrësën me numër të protokollit 2788/2023 të datës 17.03.2023 të parashtruar nga ankuesja; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1723/2023 të datës 13.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2252/2023 të datës 02.03.2023; Akt emerimin e datës 04.01.2012; Kërkesën me numër të protokollit 01-120 Nr.18173 të datës 06.02.2023 të ankueses drejtuar Zyrës së Personelit në Komunën e Prizrenit; Vërtetimin me Nr.01-120-18473/2023 të datës 06.02.2023; Shkresën e datës 18.07.1992; Listën e pagave për muajin Dhjetor-2022; Listën e pagave për muajin Janar-2023; Listën e pagave të Muajit Dhjetor-2022;

Nga administrimi i provave të lëndës, të dërguara nga pala dhe nga organi i punësimit Kolegji ka konstatuar se Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit me datën 04.01.2023 ka marr vendimin me numër NR.01-181/01-990 me të cilin është përfunduar marrëdhënia e punës së ankueses pasi që e njëjta me datën 01.01.2023 arrin moshën e pensionimit, ku ankueses me rastin e pensionimit i njihet e drejta e kompensimit në lartësi e një (1) page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve të ankueses ka konstatuar se njëjta në bazë të nenit 22 paragrafi 2.2 dhe 2.3 të Ligjit Nr.03/L-147 si dhe Rregullores Nr.33/2012 për shtesat dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civil ka kërkuar që ti bëhet kompensimi i gjashtë pagave në vlerë prej 3137.22 (tremijë e tredhjet e shtatë euro e njëzet e dy cent), nuk është i bazuar sepse organi i punësimit respektivisht Komuna e Prizrenit me rastin e marrjes se vendimit me numër 01-181/01-990 të datës 04.01.2023 ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafin 2.2 dhe 2.3 të Ligjit Nr.03/L-147 Për Pagat e Nëpunësve Civil i

cili përcakton se : Pagesa të tjera në rrethana të veçanta janë; 1. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensim për rastet në vijim: 2.2. pagesën për shkak të pensionimit.* Si dhe nenin 19 të Rregullores Nr. 33/2012 Për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil i cili përcakton se; *Neni 19 Pagesa për pensionim 1. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njehershme në vlerën e pagës së fundit.*

Ndërsa bazë te vendimit me numër Nr.01-181/01-990 te datës 04.01.2023 ankueses i është kompensuar një page në lartësi e (1) një page mujore ne vlerën e pagës se fundit ashtu siç e parasheh neni 22 paragrafi 2.2 i Ligjit Nr.03/L-147 i cili përcakton se Pagesa të tjera në rrethana të veçanta janë; 1. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensim për rastet në vijim: 2.2. pagesën për shkak të pensionimit.* Ndërsa sa i përket pretendimit se ankueses se te njëjtës i takon ti kompensohet paga lidhur me shpërblimin jubilar kolegji ka konstatuar se në bazë të listës së pagave të muajit Dhjetor-2022 të njëjtës i është kompensuar shpërblimi jubilar në vlerën prej nëntëdhjetë e shtatë (97.00) euro, ashtu siç e përcakton neni 21 i Rregullores Nr. 33/2012 Për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil i cili përcakton se; *Neni 21 Shpërblimi i përvojtorit (jubile) Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune.*

Ndërsa sa i përket pretendimit të ankueses që kompensimi po ashtu i takon në bazë të Kontratës së Përgjithshëm Kolektive, Kolegji ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”,* mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”,* bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”,* mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin e pensionimit, të njëjtës i ka përfunduar marrëdhënia e punës sipas Vendimit të datës 04.01.2023 të menaxherit të Personelit në Komunën e Prizrenit, atëherë kompensimi i gjashte pagave (6) pagave, me rastin e pensionimit sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komuna e Prizrenit , në rastin e marrjes se vendimit pas moshës se pensionimit si dhe kompensimin e një pagë pas moshës së pensionimit, për nëpunëses civil Miradije Meta, është i ligjshëm dhe i drejte sepse është marrë

në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*

*Lënda Nr. A. Nr.336/2023*

*Ilire* MEHMETI-SHAQIRI



*Procesmbajtëse*

Malësore GASHI-BAJRAKTARI



*Kryetare e Kolegjit*

*Vendimi i dërgohet:*

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së